



KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE RRETH DIALOGUT KOSOVË – SERBI PAS FORMIMIT TË DELEGACIONIT SHTETËROR

PRILL, 2019



**KËNDVËSHTRIMI I
QYTETARËVE RRETH
DIALOGUT KOSOVË – SERBI
PAS FORMIMIT TË
DELEGACIONIT SHTETËROR**

PRILL, 2019

Përgatitën: Jeta Krasniqi, Violeta Haxholli, Eugen Cakolli

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Vërejtje: Ky raport është rezultat i një hulumtimi që është realizuar në kuadër të projektit "Perspektiva Evropiane – ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë", i financuar nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.

PËRMBAJTJA

HYRJE - 6

METODOLOGJIA - 7

KONTEKSTI POLITIK MBI DIALOGUN KOSOVË-SERBI - 8

REZULTAT E HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK - 11

12

PYETJA 1 – A besoni se Delegacioni Shtetëror i Kosovës do të arrijë të mbrojë interesin e Kosovës në procesin e dialogut?

14

PYETJA 2 – A duhet të përfshihen dy partitë opozitare (LDK dhe VV) në delegacionin shtetëror për të zhvilluar negociata për marrëveshjen përfundimtare me Serbinë?

18

PYETJA 3: A mendoni se vendi duhet të shkojë në zgjedhje para vazhdimit (të fazës përmbyllëse) të dialogut?

22

PYETJA 4: Kur mendoni se duhet të arrihet marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë?

PËRFUNDIMET - 26

Hulumtimi i opinionit publik “Këndvështrimi i qytetarëve rreth dialogut pas formimit të Delegacionit Shtetëror” është i teti me radhë i zhvilluar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) që nga viti 2016, me qëllimin e nxjerrjes në pah të pikëpamjeve të qytetarëve rreth procesit të dialogut Kosovë-Serbi. Rezultatet e këtyre hulumtimeve të opinionit publik synojnë gjithashtu paraqitjen e këndvështrimit qytetar rreth pritshmërive të tyre rreth të ardhmes së këtij procesi, të cilat duhet të merren parasysh nga të gjithë aktorët e përfshirë në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi.

Faza e re e dialogut Kosovë-Serbi ka filluar më 3 korrik të vitit 2017, pas takimit në Bruksel të Presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, me Presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiç, nën ndërmjetësimin e BE-së¹. Kjo fazë është cilësuar si përmbyllëse, në kuadër të së cilës pritet arritja e një marrëveshjeje ligjërish të obligueshme mes palëve. Që nga ajo kohë, një sërë zhvillimesh politike kanë karakterizuar procesin e dialogut, të cilat janë ndërlidhur qoftë me çështjen e përfaqësimit të Kosovës në këtë proces, ashtu dhe temat të cilat duhet ose nuk duhet të diskutohen në kuadër të këtij procesi.

Raporti i hulumtimit të tetë të opinionin publik reflekton qëndrimin e qytetarëve mbi zhvillimet politike veçanërisht pas formimit të Delegacionit Shtetëror të Kosovës. Pjesa e parë e raportit ofron një përmbledhje të përgjithshme të zhvillimeve politike në Kosovë lidhur me fazën përfundimtare të dialogut. Në pjesën e dytë të raportit pasqyrohen rezultatet e hulumtimit të opinionit publik të cilat vënë në pah pritshmëritë e qytetarëve ndaj Delegacionit Shtetëror lidhur me procesin e dialogut me Serbinë, vlerësimet e tyre lidhur me nevojën e ndërtimit

të një konsensusi të gjerë politik rreth këtij procesi, si dhe qëndrimet e tyre rreth opsionit të zgjedhjeve para vazhdimit të dialogut me Serbinë.

Ky hulumtim vë në pah gjithashtu qëndrimin qytetar rreth afateve kohore se kur duhet të arrihet një marrëveshje eventuale në mes dy palëve, ku qëndrimet e qytetarëve janë të reflektuara edhe në bazë të përkatësisë së tyre etnike, si dhe në rastet të caktuara edhe sipas moshës dhe preferencave të tyre partiake.

Këto hulumtime të opinionit publik synojnë promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë të përgjegjshme. Hulumtimi organizuar në kuadër të projektit “Perspektiva Evropiane – ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë²²” financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës.

¹ Për më shumë, shih: <https://www.president-ksgov.net/sq/lajme/fillon-nje-faze-e-re-ne-dialogun-per-normalizimin-e-marredhenieve-ndermjet-kosoves-dhe-serbise> [Qasur më 08 prill, 2019]

2 Për më shumë informacione rreth dialogut Kosovë-Serbi, si dhe hulumtimeve paraprake të opinionit publik klikoni në: www.votaime.org/Public/Dialog



METODOLOGJIA

Hulumtimi është zhvilluar në nivel vendi duke përdorur metodën sistematike të rastësisë, me mostër prej 1070 të anketuarve, e dizajnuar për sigurimin e mostrës përfaqësuese, si dhe e shtresuar sipas etniteteve shqiptar, serb dhe komuniteteve tjera jo-shumicë. Hulumtimi reflekton edhe shtrirjen sipas vendbanimeve urbane dhe rurale, si dhe kompozicionin demografik të Kosovës. Hulumtimi i opinionit publik është realizuar në periudhën kohore 3–12 mars të

vitit 2019. Margjina e gabimit të këtij studimi është $\pm 3\%$ në përzgjedhje, me interval të besueshmërisë prej 95%. Përzgjedhja e amvisërisë është bërë duke shfrytëzuar metodën sistematike të rastësisë, nëpërmjet zhvillimit të anketës me personin e moshës mbi 18 vjeç i cili e ka ditëlindjen e parë më të afërt. Anketimi është realizuar ballë për ballë, me anketuesin i cili ka lexuar pyetjet dhe ka shënuar përgjigjen në pyetësonin elektronik.

Margjina e
gabimit të këtij
studimi është
 $\pm 3\%$
në përzgjedhje,
me interval të
besueshmërisë
prej **95%.**



|||||

vendim lidhur me fazën finale të dialogut, duke krijuar një ekip gjithëpërfshirës për të udhëhequr dialogun, ekip ky i kryesuar nga Fatmir Limaj, në përbërje të së cilit ishin paraparë edhe dhjetë anëtarë të tjerë që do të vinin nga koalicioni qeverisës, partitë opozitare dhe një anëtar nga shoqëria civile⁸. Dy partitë opozitare LDK dhe LVV refuzuan që të bëhen pjesë e këtij delegacioni.

Më 15 dhjetor të vitit 2018, Kuvendi i Kosovës me 59 vota miratoi rezolutën “Mbi procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë” të propozuar nga grupi parlamentar i PSD-së.⁹ Rezoluta parasheh formimin e delegacionit shtetëror të bashkëkryesuar nga Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti. Po ashtu, rezoluta parasheh edhe hartimin e Platformës dhe Ligjit për Dialogun.¹⁰ Të dy këto dokumente u miratuan në Kuvend më 7 mars të vitit 2019, gati tre muaj më vonë, edhe pse me rezolutën bazë kërkohej që këto dokumente t’i paraqiteshin Kuvendit pas një muaji. Më 15 mars të vitit 2019, partitë opozitare LDK dhe LVV e dërguan Ligjin për Dialogun në Gjykatën Kushtetuese, duke argumentuar që i njëjti ishte në kundërshtim me Kushtetutën¹¹.

Për shkak të dallimeve konceptuale rreth fazës finale të dialogut, partitë politike nuk kanë arritur të ndërtojnë një qëndrim të përbashkët, pavarësisht tentativave në Kuvend,

apo dhe tryezave të organizuara nga vetë partitë politike apo shoqëria civile. Partitë politike opozitare LDK dhe LVV kanë kërkuar që vendi të shkojë sa më parë në zgjedhje, për të krijuar institucione të reja legjitime, që do të mund të përfaqësonin Kosovën në fazën e re të dialogut me Serbinë.

Në Strategjinë e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, nevoja urgjente dhe esenciale për arritjen sa më të shpejtë të një marrëveshje gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë, paraqitet si element kryesor për garantimin e stabilitetit në rajon, por edhe si kusht për avancimin e shteteve në rrugët përkatëse të integritetit¹². Madje, edhe vetë Përfaqësuesja e Lartë e BE-së, Federica Mogherini, kishte deklaruar që marrëveshja mund të arrihet brenda vitit 2019, meqë edhe presidentët e dy vendeve janë pajtuar parimisht për një afat të tillë kohor¹³.

Në anën tjetër, letra e Presidentit të SHBA-së, Donald Trump, drejtuar Presidentit Thaçi në fund të vitit 2018, nënvizoi gjithashtu nevojën e arritjes sa më të shpejtë të marrëveshjes, meqë siç u tha në letër “[...] mundësia për arritjen e një marrëveshje tjetër, nëse përpjekjet aktuale dështojnë, është shumë e vogël”¹⁴. Këto kërkesa dhe në përgjithësi presioni ndërkombëtar për arritjen e një marrëveshje brenda vitit 2019, janë reflektuar edhe në diskursin publik në Kosovë.

8 Vendim i Qeverisë së Kosovës Nr.01/63, 3 shtator, 2018. I qasshëm në: <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/09/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-63-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%AB-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2018.pdf> [Qasur më 28 mars, 2019]

9 Kuvendi i Kosovës, “Rezoluta mbi procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë”. 15 dhjetor, 2018. E qasshme në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/2018_12_18_Rezoluta%2006-R-015.pdf [Qasur më 28 mars, 2019]

10 Po aty.


11 Për më shumë, shih: <https://www.koha.net/arberi/150647/vv-ja-e-ldk-ja-e-dergojne-ne-kushtetuese-ligjin-per-dialog/> [Qasur më 24 mars, 2019]


12 Për më shumë, shih Strategjinë e BE-së për Ballkanin Perëndimor “Një perspektivë e besueshme e zgjerimit dhe për angazhim të shtuar të BE-së me Ballkanin Perëndimor”. E qasshme në: https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-western-balkans_en.pdf [Qasur më 3 prill, 2019]

13 Për më shumë, shih: <https://gazetablic.com/mogherini-kosova-dhe-serbia-deri-ne-vitin-2019-te-arrijne-marreveshje-normalizimi/> [Qasur më 3 prill, 2019]

14 Për më shumë, shih: <https://www.president-ksgov.net/en/news/president-thaci-received-a-letter-from-the-president-of-the-usa-donald-trump> [Qasur më 3 prill, 2019]

|||||



A red speech bubble graphic with a tail pointing downwards and to the left. The text is white and bold, centered within the bubble.

REZULTATET E HULUMTIMIT TË OPINIONIT PUBLIK

PYETJA 1

A besoni se Delegacioni Shtetëror i Kosovës do të arrijë të mbrojë interesin e Kosovës në procesin e dialogut?

Përderisa Delegacioni Shtetëror vazhdon të ketë mbështetje të kufizuar nga spektri politik në Kosovë, KDI përmes këtij hulumtimi të opinionit publik ka dashur të paraqesë edhe mendimet e qytetarëve të Kosovës lidhur me këtë delegacion.

Qëndrimet e qytetarëve sa i përket nivelit të besueshmërisë ndaj Delegacionin Shtetëror janë mjaft të përafërta. Kështu, 34.8 % e qytetarëve janë shprehur se nuk besojnë që Delegacioni Shtetëror i Kosovës do të arrijë të mbrojë interesin e Kosovës në procesin e dialogut, për dallim nga 34.3% e tyre, që besojnë në se delegacioni do të mbrojë interesin e Kosovës. 28.2% e qytetarëve janë deklaruar se nuk e dinë nëse delegacioni do të mbrojë interesin e Kosovës, ndërsa 2.7% e të anketuarve nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Sa i përket përgjigjeve të qytetarëve, të paraqitura sipas përkatësisë etnike të të anketuarve, 35.9% e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, 28% e komuniteteve tjera jo shumicë dhe vetëm 1.3% e të anketuarve nga komuniteti serb besojnë që Delegacioni Shtetëror i Kosovës do të arrijë të mbrojë interesin e Kosovës në procesin e dialogut. Ndërsa, 36% e të anketuarve nga komuniteti shqiptar, 34% e komuniteteve të tjera jo-shumicë dhe 22% e komunitetit serb nuk besojnë në këtë konstatim.


34.8 %
e qytetarëve
janë shprehur
se nuk besojnë
që Delegacioni
Shtetëror i
Kosovës do të
arrijë të mbrojë
interesin e
Kosovës në
procesin e
dialogut.

JO

34.8%




36%




SHQIPTAR

22%



SERB

34%




TË TJERË

PO

34.3%




35.9%




SHQIPTAR

1.3%



SERB

28%




TË TJERË

Nuk e di

28.2%




26.7%




SHQIPTAR

56.7%



SERB

37%




TË TJERË

Refuzon të
përgjigjet / PP

2.7%




1.5%




SHQIPTAR

20%



SERB

1%



TË TJERË

|||||

PYETJA 2

A duhet të përfshihen dy partitë opozitare (LDK dhe LVV) në delegacionin shtetëror për të zhvilluar negociata për marrëveshjen përfundimtare me Serbinë?

Duke konsideruar se çdo marrëveshje eventuale mes Kosovës dhe Serbisë duhet të ratifikohet si marrëveshje ndërkombëtare me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, nevoja për konsensus të gjerë politik është e pashmangshme. Prandaj, arritja e një dakordimi sa më të gjerë mes partive politike para fazës së ratifikimit të marrëveshjes do të evitonte vonesat eventuale dhe përsëritjen e skenarëve si në rastin e ratifikimit të marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi. KDI ka bërë thirrje të vazhdueshme për konsensus dhe unitet të spektrit politik për këtë fazë të dialogut që nga fillimet e saj.

Bazuar në qëndrimet e LDK-së dhe LVV-së kundrejt Delegacionit Shtetëror, KDI përmes këtij hulumtimi ka dashur të marrë edhe mendimin e qytetarëve lidhur me atë se a duhet të përfshihen këto dy parti në Delegacionin Shtetëror për të zhvilluar negociata për marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Lidhur me këtë, 46% e qytetarëve janë shprehur se të dyja këto parti duhet të përfshihen në Delegacionin Shtetëror, ndërsa 22.1% e qytetarëve janë shprehur se asnjëra nga këto parti nuk duhet të përfshihet në Delegacionin Shtetëror. Në anën tjetër, 7.1% e qytetarëve janë të mendimit se vetëm LDK dhe 3.9% e qytetarëve mendojnë se vetëm LVV duhet të përfshihet në Delegacion. 20.9% e qytetarëve nuk kanë qëndrim lidhur me këtë pyetje.


Përgjigjet e qytetarëve në këtë pyetje në bazë të përkatësive partiake kanë shpërfaqur se 54.5% e votuesve të LDK-së dhe 54.5% votuesve të LVV-së mendojnë se të dy këto parti duhet të përfshihen

në Delegacionin Shtetëror. Në anën tjetër 16.7% e të anketuarve, që kanë deklaruar se janë votues të LDK-së, mendojnë se vetëm LDK-ja duhet të përfshihet në Delegacionin Shtetëror, krahas 19.6% të votuesve të LVV-së që mendojnë se vetëm LVV duhet të përfshihet në Delegacion. Këto të dhëna tregojnë se votuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë shprehur përkrahje më të madhe për mundësinë e përfshirjes së subjektit të tyre në procesin e dialogut, krahasuar me ata të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që kanë treguar një nivel pak më të lartë të rezervave karshi mundësisë së përfshirjes së subjektit të tyre në procesin aktual të dialogut.


Sa i përket përgjigjeve të qytetarëve sipas përkatësive etnike, 47.8% e anketuarve nga komuniteti shqiptar dhe 46% e komuniteteve tjera jo-shumicë mendojnë se që të dy partitë opozitare, LDK dhe LVV, duhet të përfshihen në Delegacionin Shtetëror. Kurse, qytetarët e komunitetit serb nuk janë përgjigjur në këtë pyetje. Në anën tjetër, 21% e respondentëve nga komuniteti shqiptar, 56% nga komuniteti serb dhe 20% e komuniteteve të tjera jo shumicë janë të mendimit se asnjëra nga këto dy parti opozitare nuk duhet të përfshihet në Delegacionin Shtetëror. Sa i përket mundësisë së përfshirjes të vetëm njëres nga partitë opozitare, në përgjithësi ky opsion është ma pak i preferuar në mesin e qytetarëve.

Po, të dyjat

46%




SHQIPTAR




TË TJERË

Jo, asnjëra


22.1%



SHQIPTAR




SERB




TË TJERË

Nuk e di


20.9%



SHQIPTAR




SERB




TË TJERË

Po, vetëm LDK


7.1%



SHQIPTAR




SERB




TË TJERË

Po, vetëm VV


3.9%



SHQIPTAR



SERB



TË TJERË

|||||

"Përgjigjet e qytetarëve në këtë pyetje në bazë të preferencave partiake kanë shpërfaqur se 54.5% e votuesve të LDK-së dhe 54.5% votuesve të LVV-së mendojnë se të dy këto parti duhet të përfshihen në Delegacionin Shtetëror. Në anën tjetër 16.7% e të anketuarve, që kanë deklaruar se janë votues të LDK-së, mendojnë se vetëm LDK-ja duhet të përfshihet në Delegacionin Shtetëror, krahas 19.6% të votuesve të LVV-së që mendojnë se

	AAK	AKR	Alternativa	NISMA	LDK
Po, të dyjat	41.8%	27.3%	55.6%	36.2%	54.5%
Po, vetëm LDK	8.2%	18.2%	11.1%	2.1%	16.7%
Po, vetëm VV	1.6%				
Jo, asnjëra	23.0%	18.2%	22.2%	29.8%	13.9%
Nuk e di	25.4%	36.4%	11.1%	31.9%	14.8%

vetëm LVV duhet të përfshihet në Delegacion. Këto të dhëna tregojnë se votuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë shprehur përkrahje më të madhe për mundësinë e përfshirjes së subjektit të tyre në procesin e dialogut, krahasuar me ata të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që kanë treguar një nivel pak më të lartë të rezervave karshi mundësisë së përfshirjes së subjektit të tyre në procesin aktual të dialogut.

PDK	PSD	VV	Lista Serbe (LS)	Tjetër
52.7%	25.9%	54.5%		46.7%
2.1%	7.4%	4.9%		
		19.6%	5.3%	6.7%
26.0%	18.5%	15.4%	52.6%	13.3%
19.2%	48.1%	5.6%	42.1%	33.3%

PYETJA 3

A mendoni se vendi duhet të shkojë në zgjedhje para vazhdimit (të fazës përmbyllëse) të dialogut?

Për shkak të mospajtimeve, që janë evidentuar edhe në kapitujt paraprak, opozita vazhdimisht ka bërë thirrje për zgjedhje të parakohshme, duke argumentuar se vetëm pas rilegjimitimit të institucioneve mund të vazhdohet me procesin e dialogut me Serbinë. Kërkesa e opozitës për shkuarje në zgjedhje të parakohshme ka qenë e ndërlidhur ngushtë edhe me mungesën e shumicës së konsoliduar të pozitës e cila është shpërfaqur edhe në punimet e Kuvendit.

Marrë parasysh këto deklarime, të cilat gjatë kohëve të fundit janë intensifikuar, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në kuadër të këtij hulumtimi ka pyetur qytetarët lidhur me mundësinë e shkuarjes në zgjedhje, si zgjidhje për ngërçin në të cilin ndodhet vendi në raport me procesin e dialogut.

Në këtë drejtim, bazuar në rezultat e marra nga respondentët, del se pjesa më e madhe e tyre, përkatësisht 43.7% sosh, nuk i shohin zgjedhjet si zgjidhje për tejkalimin e problemeve që ndërlidhen me procesin e dialogut. Sidoqoftë, një pjesë tjetër e konsiderueshme e qytetarëve, përkatësisht 31.4% e tyre, kanë deklaruar se vendi duhet të shkojë në zgjedhje para vazhdimit të fazës përmbyllëse. Ndërsa, 24.9% e të anketuarve nuk kanë mbajtur qëndrim.

Nga këto përqindje mund të konkludohet se nuk ekziston një përcaktim i qartë në mesin e opinionit publik lidhur me atë se a duhet që vendi të shkojë në zgjedhje para fazës përfundimtare të dialogut, rezultat i cili mund të ndërlidhet me skepticizmin e përgjithshëm të qytetarëve lidhur me mundësinë


e tejkalimit të mospajtimeve në mesin e spektrit politik lidhur me procesin e dialogut. Pavarësisht faktit që partitë politike kanë shprehur mbështetjen e tyre për procesin e dialogut, ato ndajnë pikëpamje dhe qasje të kundërta për mënyrën, formatin dhe rezultatet e procesit të dialogut. Prandaj, mund të thuhet që për qytetarët është vështirë e pritshme që zgjedhjet do të sillnin ndonjë ndryshim drastik në raport me procesin e dialogut në tërësi.

43.7%


e qytetarëve nuk i shohin zgjedhjet si zgjidhje për tejkalimin e problemeve që ndërlidhen me procesin e dialogut.

P0

31.4%



SHQIPTAR




SERB




TË TJERË

J0

43.7%



SHQIPTAR




SERB




TË TJERË

Nuk e di


24.9%



SHQIPTAR



SERB



TË TJERË

Parë nga aspekti i përkatësisë etnike të qytetarëve, përqindjet janë deri diku të ngjashme me mesataren e frekuencave të përgjithshme. Sidoqoftë, bie në sy një përqindje më e theksuar, përkatësisht 34.3% e qytetarëve, që kanë deklaruar se vendi duhet të shkojë në zgjedhje para vazhdimit të fazës përfundimtare të dialogut, të cilët i takojnë komunitetit shqiptar, në krahasim me vetëm 5.3% të qytetarëve nga komuniteti serb dhe 19% të qytetarëve nga komunitetet tjera jo-shumicë.

Bazuar në përcaktimin politik të votuesve, të gjeturat e hulumtimit nxjerrin në pah faktin që votuesit e partive politike në pozitë si dhe ata të PSD-së janë në përgjithësi kundër opsionit të zgjedhjeve, ndërsa votuesit e partive politike opozitare e përkrahin në masë më të madhe këtë opsion. Votuesit e LVV-së prijnë me mbështetjen e këtij opsioni me 58.7%, të pasuar nga 45.2% e votuesve të LDK-së.

Në anën tjetër, opsioni i zgjedhjeve kundërshtohet më së shumti nga votuesit e AAK-së me 60.7%, pasuar nga votuesit e PDK-së me 53.4%, votuesit e Nismës me 53.2%, votuesit e AKR-së 45.5%, si dhe votuesit e PSD-së me 42.9%.

	AAK	AKR	Alternativa	NISMA	LDK
Po	23.8%	18.2%	55.6%	19.1%	45.2%
Jo	60.7%	45.5%	22.2%	53.2%	29.5%
Nuk e di	15.6%	36.4%	22.2%	27.7%	25.2%
	100%	100%	100%	100%	100%

Votuesit e Listës Serbe paraqesin grupin e të anketuarve me nivelin më të ulët të përkrahjes së opsionit të zgjedhjeve, me vetëm 5.6%, si dhe nivelin më të lartë të mungesës së përcaktimit lidhur me këtë pyetje, me 55.6%.


PDK	PSD	VV	Lista Serbe (LS)	Tjetër
27.4%	7.1%	58.7%	5.6%	25.0%
53.4%	42.9%	30.8%	38.9%	43.8%
19.2%	50.0%	10.5%	55.6%	31.3%
100%	100%	100%	100%	100%

Kur mendoni se duhet të arrihet marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë?


32.1%
e qytetarëve
mendojnë që
marrëveshja
duhet të arrihet
gjatë vitit 2019.

Gjatë vitit 2019


32.1%



SHQIPTAR




SERB




TË TJERË

Nuk do të ketë
afate kohore


28.5%



SHQIPTAR




SERB




TË TJERË

Gjatë vitit të
ardhshëm


22.7%



SHQIPTAR




SERB




TË TJERË

Refuzon të
përgjigjet / PP


12.3%



SHQIPTAR




SERB




TË TJERË

Palët nuk do të arrijnë
marrëveshje fare


4.4%



SHQIPTAR



SERB



TË TJERË

|||||

Parë nga aspekti demografik i të anketuarve, përkatësisht grupmoshat e tyre, të dhënat tregojnë një përkrahje më të madhe të opsionit të arritjes së marrëveshjes brenda këtij viti brenda grupmoshave të reja. Përqindja e përkrahjes së këtij opsioni bie progresivisht në grupmoshat më të

	Gjatë vitit 2019	Gjatë vitit të ardhshëm
18-24	36.5%	20.2%
25-34	36.6%	21.7%
35-44	32.1%	19.9%
45-54	28.7%	26.6%
55-64	28.4%	14.7%
65+	23.2%	19.6%

|||||

vjetra, sidomos tek të anketuarit mbi 65 vjeç, që kanë nivelin më të ulët të përkrahjes së këtij opsioni, krahasuar me të gjitha grupmoshat tjera. Në kuadër të grupmoshave tjera, në përgjithësi ka përkrahje relativisht mesatare për pothuajse të gjitha opsionet.

Nuk do të ketë afate kohore	Palët nuk do të arrijnë marrëveshje fare	Refuzon të përgjigjet / PP
24.9%	10.3%	8.2%
28.1%	3.1%	10.5%
32.1%	4.6%	11.2%
26.6%	4.8%	13.3%
25.5%	6.9%	24.5%
19.6%	8.9%	28.6%

PËRFUNDIMET

Rezultatet e hulumtimit të këtij opinionit publik shpërfaqin këto të gjetura:

01

Qytetarët janë të ndarë në qëndrimin e tyre rreth besueshmërisë ndaj Delegacionit Shtetëror të Kosovës. Rreth 35% e qytetarëve të anketuar nuk kanë besim ndërsa 34% e tyre kanë besim që Delegacioni Shtetëror do të arrijë të mbrojë interesin e Kosovës në kuadër të procesit të dialogut. Pjesa tjetër e të anketuarëve nuk kanë qëndrim mbi këtë çështje.

02

Qytetarët kërkojnë që ekipi negociator të ketë përbërje që reflekton konsensus të gjerë politik lidhur me temën e dialogut Kosovë-Serbi. Rreth gjysma e qytetarëve 46% e tyre janë shprehur se LDK dhe LVV, duhet të jenë pjesë e Delegacionit Shtetëror. Ndërsa 22.1% e qytetarëve janë shprehur se asnjëra nga këto parti nuk duhet të përfshihet në Delegacionin Shtetëror.

03

Zgjedhjet nuk shihen si zgjidhje për tejkalimin e problemeve që ndërlidhen me procesin e dialogut nga pothuajse gjysma e qytetarëve përkatësisht nga 44% e tyre. Sidoqoftë, 31% e qytetarëve kanë deklaruar se vendi duhet të shkojë në zgjedhje para vazhdimin të fazës përmblylëse.

04

Lidhur me afatet kohore rreth marrëveshjes përfundimtare në mes Kosovës dhe Serbisë, opsionet e arritjes së marrëveshjes gjatë vitit 2019 dhe heqja e afateve kohore në tërësi janë më të preferuarat nga qytetarët. Rreth 32% e qytetarëve duan që marrëveshja përfundimtare në mes Kosovës dhe Serbisë të arrihet gjatë vitit 2019. Ndërsa, afërsisht 29% e qytetarëve vlerësojnë se nuk duhet të ketë fare afate kohore. Mundësia e arritjes së një marrëveshje gjatë vitit të ardhshëm përkrahet nga 22.7% e qytetarëve, ndërsa 4.4% kanë deklaruar se palët nuk duhet të arrijnë fare marrëveshje.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA